



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 745/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05/11/2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i godinës së pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës”, me nr. REF-72894-05-31-2018, me fond limit 218,082,112.5 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.08.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.

Ankimues:

BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k.
Adresa: Lagjia “Qendër”, pranë shkollës 8 vjecare, Levan, Fier.

Autoriteti kontraktor:

Spitali Rajonal Durrës.
Adresa: Lagjia nr.8, Rr. “Aleksandër Goga”, Durrës.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të BOE ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 04.06.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion i godinës së pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me nr. REF-72894-05-31-2018, me fond limit 218,082,112.5 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.08.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.

II.2 Në datën 17.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 31.08.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Euro-Alb”&”VianteKonstruksion”&”Murati” shpk	137,946,298.43 lekë Skualifikuar;
2. “Bean” & “Kupa”shpk	156,792,972.74 lekë Skualifikuar;
3. “Shpresa” shpk	166,660,826.50 lekë Kualifikuar;
4. “Alba Konstruksion” shpk	170,044,743.55 lekë Skualifikuar;
5. “Aurora Konstruksion”& “Be-Is” & ”Xhengo” shpk	173,085,562.92 lekë Skualifikuar;
6. “S.A.G” shpk	173,517,951.82 lekë Skualifikuar;
7. “Edicom” & “2T” shpk	180,569,192.00 lekë Skualifikuar;
8. “Ante-Group” & “Gjikuria” shpk	187,744,962.28 lekë Skualifikuar;
9. “Silver” shpk	188,000,000.00 lekë Skualifikuar;
10. “Anada” shpk	192,500,000.00 lekë Skualifikuar;
11. “Junik” shpk	193,836,080.00 lekë Kualifikuar;
12. “Salillari” shpk	194,073,559.24 lekë Kualifikuar;
13. “Shendelli” & “Boshnjaku B”shpk	202,747,859.93 lekë Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

“-asnjera nga shoqerite pjesmarrese ne bashkim nuk ploteson kushtin e Licenses profesionale

- Certifikatat ISO te subjektit BEAN pas verifikimit online rezultojne te anuluar dhe nuk jane te paisura me pullen vjetore

- subjekti BEAN nuk ploteson kushtin per pune te ngjashme me vlere ne nivelet e kerkuara nga AK

-Inxhinieri elektronik J. Q. nuk figuron ne listepagesen e shoqerise per periudhen e kerkuar Dhjetor 2017 – Janar 2018”

Public Health Sector

II.5.Në datën 07.09.2018 BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 2320/1 Prot. datë 13.09.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k., duke e pranuar pjesërisht ankesën, me argumentimin si më poshtë vijon:

“[...]Pergjigje: Në lidhje me pretendimin e parë se BOE plotëson kërkesën për Liçencën profesionale ju informojmë se në DST është kërkuar, ndër të tjera, që Liçenca profesionale të ketë kodet NS-4B dhe NS-14B ndërkohe që asnjë nga liçencat e paraqitura nga ana juaj si BOE nuk përmbush kete kërkesën te DST. Nga sa me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, konkludon se pretendimi nuk pranohet.

Pergjigje: Në lidhje me pretendimin e dytë se certifikatat ISO të paraqitura nga shoqëria “BEAN” shpk përmbushin kërkesat për këto pika, ju informoj më se në DST, ashtu siç është pranuar dhe nga vetë ju, janë kërkuar certifikata ISO të vlefshme. Nga konsultimi i

certifikatave ISO te shoqerise BEAN, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave veren se ne certifikate, kompania e akredituar qe ka leshuar keto ISO shprehet qarte se:

Per verifikimin e kesaj certifikate ju lutemi vizitoni faqen tone te internetit ëëë.rigcert.com/kliente; Cikli aktual i certifikimit (per te gjitha certifikatat e paraqitura) perfundon ne: 20.05.2019 me kusht te vizes vjetore. Pas verifikimit ne faqen e internetit, verejme se kompania e akredituar parashikon 3 statuse te ndryshme per certifikatat ne fjale. Me konkretisht parashikohen statuset: a. e vlefshme b. pezulluar c. Anulluar. Certifikatat e shoqerise BEAN rezultojne te jene ne statusin “anulluar”, pra nuk jane në statusin “e vlefshme” siç kërkohet në DST. Gjithashtu në certifikatat e paraqitura nga shoqëria “BEAN” shpk shkruhet qartë se këto certifikata janë të vlefshme me kusht te vizes vjetore. Ky rinovim nuk është kryer pasi këto certifikata jo vetëm rezultojnë të anuluar, por nuk kanë as pullën e rinovimit vjetor. Nga sa me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, konkludon se pretendimi nuk pranohet.

Pergjigje: Në lidhje me pretendimin e tretë ju informojmë se në pikën 1.a) dhe 1.b) të pikës 2,3 “Kapaciteti Teknik” të “Kritereve të veçanta për kualifikim” është kërkuar: a) “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në ndërtim, me vlerë jo më pak se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe të realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit”; dhe b) “Punë të ngjashme deri ne nje kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera ne ndertim e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit është ne nje vlere jo me me pak se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet”. Plotësimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme. Kjo kërkesë në DST është bërë bazuar në nenin 26 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014, e ndryshuar, si dhe në njoftimin nr. 3441/1, datë 20.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik ku përcaktohet se: “Në shumë raste, autoritetet kontraktore kanë përcaktuar në DT që informacioni mbi xhiron mesatare vjetore dhe kontratat e ngjashme të jetë i tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik, ndërkohë që sipas parashikimeve të nenit 46 të LPP si dhe neneve 26, 27, 28 të VKM nr 914, datë 29.12.2014, ky informacion kur është i mundur, duhet të përcaktohet për 3 vitet e fundit, nga data e zhvillimit të tenderit. Pra, si referencë kohore duhet të jenë 3 vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, dhe jo 3 vitet e fundit të aktivitetit të operatorit ekonomik”. Operatori Ekonomik BEAN shpk, si pjese e bashkimit te operatoreve me 28% te vleres se punimeve, duke iu referuar Nenit 74, pika 3 e VKM Nr.914, date 29.12.2014, 6 ndryshuar, sipas te cilit “Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 6, të nenit 26, të këtyre rregullave (Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit), plotësohet nga anëtarë, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”, duhet te plotesoje kushtin e puneve te ngjashme per nje objekt te vetem ne ndertim duke marre per baze vleren 30'531'495 Leke pa Tvsh (218'082'112.50 Leke pa tvsh * 28% * 50%).

Operatori Ekonomik BEAN shpk, me kontraten e paraqitur me objekt “Rikualifikim Fasdash” me Bashkine Durres nuk e permbush kerkesen e AK sipas pikes 2.3 nenpika l/a te DST “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm ne ndertim, me vlere jo me pak se 50% e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe të realizuar giate tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit”. Me konkretisht, Komisioni, sipas kerkesave ne DST, vendosi te konsideroje si pune te ngjashme te realizuara gjate 3 viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit, punet e realizuara nga OE duke filluar nga data 17.08.2015 e ne vazhdim, periudhe qe perfshin 3 vitet e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, duke konsideruar pune te realizuara faturat tatimore te shitjes pergjate intervalit 17.08.2015-17.08.2018, dhe jo teresine e kontrates per pune te realizuara jashte ketij intervali kohor. Gjate ketij arsytimi, jemi bazuar edhe ne nje vendim precedent te Komisionit te Prokurimit Publik (Vendimi Nr.521/2016, date 11.07.2016) per nje rast interpretimi identik. Kontrata e paraqitur nga BEAN shpk “Rikualifikim Fasdash”, me Autoritet Kontraktor Bashkia Durres nuk permbush kerkesat e Autoritetit Kontraktor sipas DST. Me konkretisht, punet e realizuara ne kete kontrate gjate tre viteve te fundit, duke vleresuar faturat e paraqitura per kete periudhe (intervali kohor 17.08.2015-17.08.2018), nuk e permbushin kriterin per “Punë të ngjashme për një objekt të vetëm ne ndertim, me vlere jo me pak se 50% e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe të realizuar gate tri viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit”. Llogjikisht, Operatori Ekonomik BEAN sh.p.k., me kontraten e paraqitur nuk e permbush as kerkesen e AK sipas pikes 2.3 nenpika l/b te DST “Punë të ngjashme deri ne nje kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera ne ndertim e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit te tenderit është ne nje vlere jo me pak se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet”, per arsye sepse vlera totale e puneve te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit nuk e ploteson kete kusht. Nga sa me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, konkludon se pretendimi nuk pranohet.

Pergjigje: Në lidhje me pretendimin për prezencën në listëpagesë për 6 muajt e fundit të inxhinierit elektronik z.J. Q., ju informojmë se në pikën 4, c të kapacitetit teknik kërkohet: Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin teknik për kryerjen e të gjitha sherbimeve në këtë objekt dhe zbatimin e kontrates, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, cv, librezat e punës si dhe me vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj per periudhen (Dhjetor 2017-Maj 2018) si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 muajt e fundit (Dhjetor 2017-Maj 2018). Sa më sipër periudha 6 muajt e fundit nënkupton periudhën (Dhjetor 2017-Maj 2018), dhe rrjedhimisht inxhinieri elektronik z.J. Q. nuk e ploteson kete kriter per periudhen e kerkuar. Ne lidhje me pretendimin se BOE “BEAN” shpk & “KUPA” shpk ka paraqitur dokumentacion edhe per nje tjetër ing elektronik, konkretisht z.R. Z. i punesuar nga shoqeria BEAN, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pas verifikimit te dokumentacionit perkates, vlereson te permbushur kriterin e DST mbi inxhinierin elektronik. Nga sa me lart, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, konkludon se pretendimi pranohet.[...]”

II.7.Në datën 21.09.2018 BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]1. Ne lidhje me arsyen se asnjëra nga shoqëritë pjesëmarrëse në bashkim nuk plotëson kushtin e Licenses profesionale kontestojme sa më poshtë:

Ne dokumentat standarte të tenderit në kriteret e vecnata të kualifikimit në kapacitetin teknik në pikën 5 janë kërkuar Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duke specifikuar kategoritë e licencave. Për vertetimin e këtij kriteri BOE “BEAN” shpk & “KUPA”shpk kanë paraqitur licensat profesionale ku provojnë se zotërojnë të gjitha kategoritë e kërkuara dhe nuk mundon asnjë prej pikave të kërkuara në DST, fakt ky i pa mohueshem pasi janë të evidentuara në licensat e shoqërive. Gjithashtu sqarojmë se BOE “BEAN” shpk & “KUPA”shpk ka bërë bashkim operatorësh ku ka ndarë në mënyrë të detajuar të gjitha zërat e punimeve me vlera perkatëse dhe rezultojnë se sipas ndarjes së bërë secili prej anëtarëve referuar zërave dhe vlerës në leke që ka marrë persiper nuk e tejkalon kategorinë e licenses profesionale që secili prej anëtarëve zotëron. Sipas ligjit të prokurimit publik është shprehimisht e cilesuar se qellimi kryesor I bashkimit të operatorëve ekonomik është bashkimi I kapaciteteve për të marrë pjesë në një procedurë prokurimi, gjithashtu në nenin 74, pika 3 e VKM nr.914. datë.29.12.2014 “Për Regullatë Prokurimit Publik”, përcaktohet se ...

Per sa me sipër duket qartë se BOE “BEAN” shpk & “KUPA” shpk e plotëson kriterin e kërkuar, për këtë arsye kërkojmë që pretendimi jonë të merret parasysh dhe të bëhet korigjimi.

2. Në lidhje me arsyen se Certifikatat ISO të subjektit BEAN pas verifikimit online rezultojnë të anuluar dhe nuk janë të paisura me pullën vjetore kontestojmë sa më poshtë: Në dokumentat standarte të tenderit në kriteret e vecnata të kualifikimit në kapacitetin teknik pika 6 është kërkuar 6. Certifikatat me të cilat duhet të jetë e pajisur Shoqëria: Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat: a) Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001 “Sistemet e menaxhimit të cilësive”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. b) Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001 “Sistemet e menaxhimit të ambientit”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë. c) Shoqëria duhet të paraqesë certifikatën OHSAS 18001 “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë së punës”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë d) ISO Certifikate e Sistemit të Menaxhimit të Integruar PAS 99. Për plotësimin e këtij kriteri OE “BEAN” shpk si pjesë e bashkimit ka paraqitur certifikatat e CERTIND SA që është një shoqëri e retifikuar dhe I akredituar, të cilat janë me vlefshmeri 20.05.2019, të firmosura dhe të vëlosur. Pretendimi juaj se nuk gjenden në

faqen e internetit nuk qendron dhe eshte ne kundershtrim me legjislacionin e prokurimit public dhe me kriteret e vendosura pasi ne kriter nuk kerkohet vlefshmeria ne faqe internet. Per sa me siper duket qarte se BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk e ploteson kriterin e kerkuar i zoteron ISOT e kerkuara. Per kete arsye kerkojme qe pretendimi jone te merret parasysht dhe te behet korrigjimi.

3. Ne lidheje me arsyen se subjekti BEAN nuk ploteson kushtin per pune te ngjashme me vlere ne nivelet e kerkuara nga AK kontestojme sa me poshte: Ne dokumentat standarte te tenderit eshte kerkuar kontrate e ngjashme ne vleren prej 50 % te fondit limit, per te vertetuar kete kriter BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk ka paraqitur kontraten e ngjashme me objekt "Rikualifikim Fasdash" me Bashkine e Durrësit me vlere te realizuar prej 31,081,562 leke pa tvsh, si dhe kontraten e ngjashme Ndertim Infrastruktures Rugore, rrjetit te jashtem inxhinierik dhe kabinave te objekteve ne kompleksin Neë Born" me vlere totale prej 250.700.014 leke pa tvsh. Sipas kontrates se bashkepunimit ndarja e % eshte BEAN 28% QE DO TE THOTE qe duhet te paraqese kontrate te ngjashme ne vleren prej 30,531,495 leke, nga dokumentat e dorezuara figuron qe velra e kontrates se ngjashme te BEAN eshte "Rikualifikim Fasdash" me Bashkine e Durrësit me vlere te realizuar prej 31,081,562 leke pa tvsh. KUPA ka marre persiper 72% ne vleren prej 78,509,560 nga dokumentat e dorezuara figuron qe velra e kontrates se ngjashme te KUPA eshte "Ndertim I Infrastruktures Rugore, rrjetit te jashtem inxhinierik, dhe kabinave te objekteve ne kompleksin Neë Born" me vlere totale prej 250,700,014 leke pa tvsh. Pra nga sa me siper paraqitem duket qarte qe edhe vlera prej 50% e fondit limit plotesohet edhe nga I gjithë grupi por edhe sipas perqindjeve te marra persiper. Per sa me siper duket qarte se BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk e ploteson kriterin e kerkuar, per kete arsye kerkojme qe pretendimi jone te merret parasysht dhe te behet korrigjimi.

4. Ne lidheje me arsyen se Inxhinieri elektronik J.Q. nuk figuron ne listepagesen e shoqerise per periudhen e kerkuar Dhjetor 2017 Janar 2018 kontestojme sa me poshte: Ne dokumentat standarte te tenderit ne kriteret e vecnata te kualifikimit ne kapacitetin teknik pika 4 germa c) eshte kerkuar operatori ekonomik te kete " 1 (nje) Inxhinier Elektronik/Telekornunikacioni, te figuroje ne listepagesat e shoqerise per te pakten 6 muajt e fundit per te cilin te paraqitet kontrate pune, diplome perkatese, certifikate perkatese, libreze pune, C V. " Per te permbushur kete kriter BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem provues sikunder kerkohet qe jane Kontraten e punes nr.27 Rep, nr.16 Kol, date 22.02.2018 te lidhur me ing elektronik Z. J.Q. dhe shoqerise Kupa Listepagesat dhjetor 2017 qershor 2018, ku rezulton se ne figuron i rregjistruar qe ne listepagesen e muajit mars 2018 e ne vazhdim. Sikunder evidentohet qarte ne kriterin e kerkuar nuk eshte shprehur periduha kohore dhjetor 2017 -Janar 2018 por thuhet per te pakten 6 muajt e fundit. Gjithashtu BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk ka paraqitur dokumentacion edhe per nje tjetër ing elektronik konkretisht : Kontraten individuale te punes date 15.11.2017 te lidhur me ing elektronik Z. R. Z. dhe shoqerise BEAN. Listepagesat dhjetor 2017 qershor 2018, ku rezulton se Rodolf Zyka figuron i rregjistruar qe ne listepagesen e muajit dhjetor 2017 e ne vazhdim. Per sa me siper cituam duket qarte se BOE "BEAN" shpk & "KUPA" shpk e ploteson kriterin e kerkuar se zoteron

Ing elektronik si dhe figuron ne listepagesat e shoqerise . Per kete arsye kerkojme qe pretendimi jone te merret parasysh dhe te behet korrigjimi [...]”

II.9.Në datën 04.10.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2444/2prot., datë 02.10.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[...]-asnjera nga shoqerite pjesmarrese ne bashkim nuk ploteson kushtin e Licenses profesionale[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se: _____

III.1.1.Në shtojcën 12, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

a. PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

- *NP- 1 A Punime germimi ne toke.*
- *NP- 2 C Ndertime civile dhe industriale*
- *NP- 3 C Rikonstruksione dhe Mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasade*

• *NP-12 A Punime te Inxhinierise se Mjedisit.*

b. PUNIME SPECIALE NDERTIMI

- *NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve.*
- *NS-2 C Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.*
- *NS-3 C Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).*
- *NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.*
- *NS-12 B Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimit.*
- *NS-14 B Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV, etj.*
- *NS-18 A Punime topogjeodezike sipas modelit të lëshuar nga MTI;*

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturas ne Republikën e Shqipërisë, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.”

III.1.2.Me anë të shtojcës “Shtojcë në DST” autoriteti kontraktor ka kryer modifikimin e kriterëve si më poshtë vijon:

“Pika 5 Licënsa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

ISHTE

a. PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP- 1 A Punime germimi ne toke.

NP- 2 C Ndertime civile dhe industriale

NP- 3 C Rikonstruksione dhe Mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasade

NP-12 A Punime te Inxhinierise se Mjedisit.

b. PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve.

NS-2 C Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.

NS-3 C Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).

NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS-12 B Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimit.

NS-14 B Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV, etj.

NS-18 A Punime topogjeodezike

BEHET

a) PUNIME TE PERGJITHSHME NDERTIMI

NP- 1 A Punime germimi ne toke.

NP- 2 A Ndertime civile dhe industriale

NP- 3 C Rikonstruksione dhe Mirembajtje godinash civile e industriale, veshje fasade

NP-12 A Punime te Inxhinierise se Mjedisit.

b) PUNIME SPECIALE NDERTIMI

NS-1 A Punime per prishjen e ndertimeve.

NS-2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirembajtja e tyre.

NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë levizëse, transportues).

NS-4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe kondicionimit.

NS-14 B Impiante te brendshme elektrike, telefonike, radiotelefon TV, etj.

NS-18 A Punime topogjeodezike”

III.1.2.Në nenin 46, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e

kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”

III.1.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.4. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k, rezulton se, është paraqitur dokumenti Kontratë për Bashkim të Përkohshëm të Shoqërive, ndërmjet shoqërisë “Bean” sh.p.k. dhe shoqërisë ”Kupa” sh.p.k., nga ku shoqëria “Bean” sh.p.k. merr përsipër të realizojë 28% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi dhe shoqëria ”Kupa” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 72% të vlerës së preventivit të ofertuar në këtë procedurë prokurimi.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga BOE ankimues, në mënyrë elektronike, nëpërmjet Sistemit të Prokurimeve Elektronike, KPP vëren se, në përmbushje të

kriterit të sipërcituar, ky i fundit ka paraqitur Licencen NZ.2835/19, lëshuar nga MTI, për operatorin ekonomik “Bean” sh.p.k. dhe Licencen NZ.4901/8, lëshuar nga MTI, për operatorin ekonomik “Kupa” sh.p.k. Në këto licenca profesionale, konstatohet se asnjë prej operatorëve pjesëtarë të bashkimit të operatorëve ankimues nuk është i licencuar sipas klasifikimit në kategoritë “NS-4B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastic, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese” dhe “NS-14B Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni, TV etj.”, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi. Operatorët ekonomik pjesëtarë të bashkimit të operatorëve ankimues disponojn secili licence për kryerjen e punimeve të kategorisë NS-4 dhe NS-14 në klasifikimin A dhe jo në klasifikimin sipas kërkesave B, fakt ky i pranuar edhe nga vetë ankimuesi. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, BOE ankimues nuk disponon kategorinë e licencave për kryerjen e punimeve sipas klasifikimit të kërkuar nga autoriteti kontraktor, e për rrjedhojë ndodhet në kushtet e mospërmbushjes të kriterit të vendosur në shtojcën 12, pika 2.3.5 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën përkatëse. Pretendimi i ankimuesit se *“Gjithashtu sqarojme se BOE “BEAN” shpk & “KUPA”shpk ka bere bashkim operatoresh ku ka ndare ne menyre te detajuar te gjitha zerat e punimeve me vlera perkatese dhe rezulton se sipas ndarjes se bere secili prej anetare referuar zerave dhe vleres ne leke qe ka marre persiper nuk e tejkalon kategorine e licenses profesionale qe secili prej anetareve zoteron”*, referuar në legjilacionin e posacëm në fuqi, KPP sqaron se licencat profesionale për shoqëritë që ushtrojnë veprimtari ndërtuese në zbatim, lëshohen në mënyrë individuale për secilën shoqëri dhe klasifikimi lidhur me kategoritë përkatëse është tërësisht individuale dhe nuk mund të bashkohet më shoqëri të tjera. Neni 74, pika 3 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon përmbushjen e kriterëve në përpjestim me pjesëmarrjen në bashkim vetëm për kërkesat ekonomike, financiare, profesionale (stafi) dhe ato teknike (mjetet).

III.1.7. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së*

prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me intepretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k, nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k, mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “[...] - Certifikatat ISO te subjektit BEAN pas verifikimit online rezultojne te anuluar dhe nuk jane te paisura me pullen vjetore [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1.Në shtojcën 12, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“6. Certifikatat me të cilat duhet të jetë e pajisur Shoqëria:

Shoqëria duhet të paraqesë Certifikatat:

a)Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten ISO 9001 “Sistemet e menaxhimit te cilesise”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

b)Shoqëria duhet te paraqesë Certifikaten ISO 14001 “Sistemet e menaxhimit te ambientit”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

c)Shoqëria duhet të paraqesë certifikatën OHSAS 18001 “Sistemet e menaxhimit te shendetit dhe sigurise se punetoreve ne pune”, (e vlefshme). Certifikata të jetë e lëshuar nga

një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë d)ISO Certifikate e Sistemit të Menaxhimit të Integruar PAS 99.”

III.2.2. Nga verifikimi i kryer nga KPP, për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Bean” sh.p.k., pjesëtar i bashkimit të operatorëve akimues, ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.):

- Certifikatë “Sistem menaxherial të Cilësisë” ISO 9001:2008 / S SH ISO 9001:2008, me numër 15307C, lëshuar nga shoqëria e certifikimit “CERTIND SA”, për shoqërinë “Bean” sh.p.k.
- Certifikatë “Sistem menaxherial të ambientit” ISO 14001:2004 / S SH ISO 14001:2004, me numër 15307M, lëshuar nga shoqëria e certifikimit “CERTIND SA”, për shoqërinë “Bean” sh.p.k.
- Certifikatë “Sistem menaxherial të shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve në punë” OHSAS 18001:2007, me numër 15307SS, lëshuar nga shoqëria e certifikimit “CERTIND SA”, për shoqërinë “Bean” sh.p.k.
- Certifikatë “Sistem menaxherial të integruar”, PAS 99:2012 me numër 15307PAS, lëshuar nga shoqëria e certifikimit “CERTIND SA”, për shoqërinë “Bean” sh.p.k.

III.2.3. Në nenin 46, pika 2 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: 2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]*”

III.2.4. Ndërsa në nenin 53 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*”

III.2.5. Në nenin 30 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “*1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*”

III.2.6.Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar në plotësim të kriterit të sipërcituar, KPP vëren se në Certifikatat ISO 9001:2008; ISO 14001:2004; OHSAS 18001:2007; PAS 99:2012 të dorëzuara nga operatori ekonomik “Bean” sh.p.k., pjesëtar i bashkimit të operatorëve akimues në mënyrë elektronike, përcaktohet se data e certifikimit është 21.05.2016 dhe data e skadencës së certifikimit aktual është 20.05.2019 “Me kusht të vizës vjetore”. Gjithashtu, në këto Certifikata, përcaktohet “Certifikatë e vlefshme vetëm me kushtin e rinovimit vjetor”. Nga shqyrtimi i certifikatave të sipërcituara, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se këto e fundit nuk disponojnë vizën vjetore (pullën vjetore) në vendin e posaçëm të saj, për vitet 2017 dhe 2018, sikurse është përcaktuar në këtë certifikata. KPP gjykon se certifikatat ISO 9001:2008; ISO 14001:2004; OHSAS 18001:2007; PAS 99:2012 të dorëzuara nga operatori ekonomik “Bean” sh.p.k. nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara për tu konsideruar si certifikata të rregullta dhe të vlefshme, pasi në këto të fundit përcaktohet në mënyrë eksplicite se vlefshmëria e saj është e kushtëzuar nga disponimi i vizës vjetore (pulla vjetore). Vlen të theksohet se, dokumentat të cilat ngarkohen në mënyrë elektronike në përmbushje të kriterëve të kërkuara nga autoriteti kontraktor, konsiderohen të vlefshme nga ky i fundit, vetëm kur këto dokumente janë në formën dhe përmbajtjen e kërkuar, si dhe disponojnë të gjitha elementët e domosdoshëm të sigurisë dhe vlefshmërisë. Për këto arsye, KPP gjykon se ndodhemi para faktit që operatori ekonomik “Bean” sh.p.k. nuk ka dorëzuar dokumenta që plotësojnë të gjithë elementët e domosdoshëm për tu konsideruar të vlefshëm dhe si rrjedhojë nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën 12, pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me nenin 74, pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar lidhur me disponueshmërinë e certifikatave ISO 9001:2008; ISO 14001:2004; OHSAS 18001:2007; PAS 99:2012.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k, nuk qëndron.

III.3.Lidhur me pretendimet e tjera të BOE ankimues “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi BOE ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi operatorësh ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Bean” sh.p.k. & “Kupa” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Rikonstruksion i godinës së pediatriisë për Spitalin Rajonal Durrës*”, me nr. REF-72894-05-31-2018, me fond limit 218,082,112.5 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.08.2018, nga autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Durrës.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1523 protokoli Datë 21.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

